



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2593/Prot.

Vlorë më, 12.11.2024

VENDIM
Nr. 50, datë 12.11.2024
PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT PROFESIONAL DY VJECAR TË STDUDIMIT,
"SPECIALIST NË SHËRBIME DHE OPERCIONE DETARE" PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49, 71, 72, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 25 të Statutit të Uv-së, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe referuar propozimit të Rektorit të UV-se, ardhur me shkresë 2536/22 prot, date, 07.11.2024 Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 12.11.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Shkencave Detare, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, për hapjen e programit të studimit "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet AKFAL.
4. Vendimi përcillet për miratim të mëtejshëm në MAS DHE QSHA

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA